

# Platforma për të Drejtat e Njeriut

## Constitutional Articles: Mbrojtja e Pronës

1. E drejta e pronës është e garantuar. 2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik. 3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet. 4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente. 5. Prona intelektuale mbrohet me ligj.

## Constitutional Paragraph: Neni 46 para 2

Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.

### Instrumentet ndërkombëtare

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj  
Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj

### Nenet

Prot. 1 neni 1

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk çënojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera

### Ligjet

### Nenet

Ligji nr. 2004/32 për familjen i Kosovës dhe  
LIGJI NR. 06/L-077 PËR  
NDRYSHIMIN DHE  
PLOTËSIMIN E LIGJIT  
NR. 2004/32 PËR  
FAMILJEN I KOSOVËS  
Ligji nr. 2004/32 për familjen i Kosovës dhe  
LIGJI NR. 06/L-077 PËR  
NDRYSHIMIN DHE  
PLOTËSIMIN E LIGJIT  
NR. 2004/32 PËR  
FAMILJEN I KOSOVËS

(1) Të drejtat e anëtarëve të bashkësisë familjare në lidhje me sendet e paluajtshme regjistrohen në regjistrat publik për vërtetimin e pronësisë (Regjistri i Tokës). Regjistrimi bëhet në emër të të gjithë anëtarëve të bashkësisë familjare të cilët më punën e tyre kanë marrë pjesë në fitimin e pjesëve të pacaktuara. (2) Nëse në ato regjistra është regjistruar si pronar një anëtar i bashkësisë familjare në cilësinë e pronarit (pronar i vetëm), gjer sa nuk ndryshohet me anë të një propozimit të përbashkët të të gjithë anëtarëve të tjerë të bashkësisë familjare, faktet që kanë të bëjnë me të drejtën e pasurisë së përbashkët nuk ndryshojnë në statusin juridik të pronësisë së përbashkët.. (3) Kontrata me të cilën anëtari i bashkësisë familjare, i cili është regjistruar si pronar i vetëm në regjistrat publik e tjetëron apo ngarkon paluajtshmërinë e fituar brenda bashkësisë familjare, anëtarët tjerë të bashkësisë familjare mund ta godasin këtë veprim. Kjo mund të jetë e mundshme vetëm nëse në kohën e lidhjes së kontratës regjistri përmban fakte mbi të drejtën e pronësisë së përbashkët apo nëse në kohën e lidhjes së kontratës me palën e tretë pronari i vetëm e ka bërë publike padyshim se pronësia është nën bashkësinë familjare.

438

Ligji për maredhënjët e detyrimeve Nr. 04/L-077  
Ligji për maredhënjët e detyrimeve Nr. 04/L-077

1. Me kontratën e shitjes detyrohet shitësi që sendin të cilin e shet t'ia dorëzojë blerësit dhe t'ia kalojë të drejtën e pronësisë, ndërsa blerësi detyrohet që shitësit t'ia paguajë çmimin dhe ta pranojë sendin. 2. Shitësi i ndonjë të drejte tjetër detyrohet se blerësit do t'ia kalojë të drejtën e shitur, ndërsa kur ushtrimi i asaj të drejte kërkon posedimin e sendit, t'ia dorëzojë edhe sendin.

Neni 25

LIGJI NR. 06/L -105 PËR  
TATIMIN NË TË  
ARDHURAT E  
KORPORATAVE  
LIGJI NR. 06/L -105 PËR  
TATIMIN NË TË  
ARDHURAT E  
KORPORATAVE

1. Kompania që shpërndan pronën, përveç aksioneve të një aksionari, duke pasur parasysh interesin e aksionarit, njih fitimin ose humbjen sikur ajo pronë t'i ishte shitur aksionarit në vlerën e hapur të tregut. 2. Vlera e pronës së shpërndarë për aksionarin vlerësohet sipas vlerës së hapur të tregut të asaj prone. 3. Në rast të shpërndarjes së dividendëve të aksioneve që nuk ndërrojnë hisen e pjesëmarrjes së fituesit, kompania nuk e njih fitimin as humbjen dhe kështu aksionari nuk realizon të ardhura.

LIGJI Nr. 06/L-005 PËR  
TATIMIN NË PRONËN  
E PALUAJTSHME  
LIGJI Nr. 06/L-005 PËR  
TATIMIN NË PRONËN  
E PALUAJTSHME

Neni 1

Ky Ligj vendos tatimin mbi pronën e paluajtshme dhe përcakton rregullat dhe procedurat themelore për administrimin e tatimit në pronën e paluajtshme nga komunat dhe Ministria e Financave.

**decisionTitle\***    **decisionDescription\***

Kozac?o?lu v.  
Turkey

Kozac?o?lu v. Turkey [GC], no. 2334/03, § 63, 19 February 2009: Gjykata ka sqaruar se [shqetësimi] që ka të bëjë me këtë ekuilibër është reflektuar në strukturën e nenit 1 të Protokollit Nr. 1 në tërësi, duke përfshirë, pra, fjalinë e dytë, e cila duhet të lexohet në dritën e parimit të përgjithshëm të përcaktuar në fjalinë e parë. Në veçanti, Gjykata ka theksuar se duhet të ekzistoj një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të realizohet nga çdo masë e zbatuar nga Shteti, përfshirë masat që privojnë një person nga pasuritë e tij.

Tre Traktörer  
AB v. Sweden,  
7 July

Tre Traktörer AB v. Sweden, 7 July 1989: Aplikantit iu hoq një licencë e alkoolit për një restorant me efekt të menjëhershëm për shkak të parregullsive financiare duke ndikuar në mbylljen e restorantit. Qeveria argumentoi se një licencë për të shitur pije alkoolike nuk mund të konsiderohej si një "posedim" në kuptimin e nenit 1 të Protokollit. Sidoqoftë, si Komisioni, ashtu edhe Gjykata mendon se interesat ekonomike të lidhura me drejtimin e [restorantit] ishin posedime "për qëllimet e nenit 1 të Protokollit. Në të vërtetë, Gjykata ka gjetur tashmë që mirëmbajtja e licencës ishte një nga kushtet kryesore për ushtrimin e biznesit të ndërmarrjes së aplikantit dhe se tërheqja e saj kishte efekte të dëmshme në vlerën e restorantit. Një tërheqje e tillë, pra, përbën, në rrethanat e çështjes, një ndërhyrje në të drejtën e [kërkuesit] për 'gëzimin paqësor të [pasurive] të tij". Lejet e dhëna për restorant u konsideruan si 'pasuri' në kuptimin e nenit 1. Ndërhyrja në të drejtat pronësore u konsiderua proporcionale ndonëse aplikantit nuk iu ofrua asnjë kompensim për humbjen e shkaktuar dhe efekti i legjislacionit u vlerësua si i rëndë.